



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2021:135519

Datë: 06.03.2025

Numri i dokumentit: 06949428

**C.nr.216/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Laureta Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.M nga fshati K., komuna e Novobërdës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Marigona Berisha nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës sipas kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore më datë 06.03.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë ç ë s h t j e s**

**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.M nga fshati K., komuna e Novobërdës dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit për **kualifikim shkollor – me fakultet** për periudhën kohore nga data tetor 2018 deri me janar 2021, t’ia paguaj shumën prej **2.605.98€**, me kamatë ligjore prej 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II.** Detyrohet e paditura që paditësit, t’ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 699.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, më datë 28.06.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit. Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar në SHME "Skënderbeu" në cilësinë e mësimdhënësit, është i diplomuar në universitetin AAB dhe ka kualifikimin master i arteve në kulturë fizike dhe sport. Tutje ka theksuar se duke iu referuar kontratës kolektive të arsimit e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2017 paditësi asnjëherë nuk ka përfituar diferencën në pagë prej 35 % mbi bazën e kualifikimit. Paditësi sipas kontratës së punës realizon pagën mujore në vlerë prej 421.00 Euro dhe për kualifikimin e tij i njëjti realizon shtesën në vlerë prej 58.32 Euro e cila nuk përkon me vlerën 35%. Gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar si dhe të paguajë shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimare të gjykatës.

E paditura, me përgjigje në padi të datës 26.12.2023, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pa bazë ligjore pasi që e paditura asnjëherë nuk ka paguar punëtorët për kualifikim, nuk ka bazë ligjore për këtë siq është shembulli i komunave tjera në Kosovë. E paditura vlerëson se Kontrata e Përgjithshme Kolektive në Kosovë e vitit 2017 dhe 2021 nuk paraqet bazë ligjore

pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës-MASHT-i ka shkëputut më dt.21.11.2022 Kontratën Kolektive të dt.20.01.2021. Në bazë të neneve 78 dhe 79 të Ligjit të Punës dhe nenit 74 të Ligjit për Shërbyesit Publik paditësja ka pasur për obligim ti drejtohet të paditurë me kërkesë dhe pas marrjes së përgjegjes negative ti drejtohet gjykatës andaj edhe padia është e parakohshme. Në fund i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe të njëjtën ta obligojë për pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje kontestuese i ka administruar këto prova materiale:

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës të datës 01 shtator 2018, u vërtetua se paditësi ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e Novobërdës-DKA më dt.03 shtator 2018, për kohë të caktuar, ku i njëjti sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si profesor në SHME dhe PNF Skenderbeu Makresh në Bostan, në lëndën kulturë fizike dhe sport me pagë mujore 413.95€ në muaj, fondi i orëve 18.

Nga leximi i Diplomës me nr. 078/21 e datës 23.01.2021, u vërtetua fakti se paditësi fitoi gradën Master i Arteve në Kulturë Fizike dhe Sport, në nivelin e 7 të kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve KKK/KEK në kolegjin AAB në Prishtinë që nga data 23.01.2021. Nga leximi i Diplomës me nr. 161/14 e datës 08 mars 2014, u vërtetua fakti se paditësi mbaroi studimet themelore universitare në programin Kulturë Fizike dhe Sport, dhe mori titullin Baçelor në Kulturë Fizike dhe Sport në nivelin 6 (KKK/KEK) në kolegjin AAB në Prishtinë që nga data 08.03.2014.

Nga Lista e pagave për muajin maj 2021, u vërtetua fakti se paditësi ka pagën neto 433.58€, dhe sipas kualifikimit fakultet shumë prej 57.32 Euro.

Nga Ekspertiza financiare e datës 11.04.2022 nga eksperti financiar Milaim Korbaj është konstatuar se tek paditësi paga neto për periudhën kohore tetor 2018 deri tetor 2021 duhet të jetë 18.663.23 Euro dhe diferenca për pagesë është 2.605.98 Euro. Për shkakë të kualifikimi kualifikim shkollor – me fakultet, është shtesa në pagë 35% e pagës neto 421€, në shumën prej 123.65 deri në muajin janar të vitit 2021 dhe shume prej 160.65€, pas muajit janar 2021 deri në tetor 2021, ndërsa ka realizuar shumë prej 57.32€, ndërsa ka mbetur pa u realizuar shuma prej 2,605.98€.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditëses është e themeltë. Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara në mbështetje të nenit 398 të LPK-së. Gjykata, para se të vendosë në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestuese, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës,

respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura.

Andaj, gjykata, në këtë çështje kontestuese sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 7 dhe 8 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi. Kërkesat e paditësit bazën ligjore e ka në nenin 35 par. 7 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit.

Me dispozitën e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 është përcaktuar se “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit, edhe atë: 1.1. Mësimdhënës me Shkollë Normale, 10 % e pagës bazë; 1.2. Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare, 19 % e pagës bazë; 1.3. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë, 35 % e pagës bazë; 1.5. Përparimet në karriere, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10 %”.

Nga leximi i Vendimit nr.01/33 e dt.29.08.2008, u vërtetua fakti se Qeveria e Republikës së Kosovës respektivisht kryeministri i saj më dt.29.08.2008, kishte marrë vendim që nga data 01.09.2008, të gjithë mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të liqencimit. Nga ky vendim kanë përfituar mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, 10% ata të cilët kanë qenë me diplomë të shkollës normale, 19% ata të cilët kanë qenë me shkollë të lartë pedagogjike, 27% të pagës bazë ata të cilët kanë diplomë universitare dhe 35% të pagës bazë ata të cilët kanë diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (magjistraturë dhe doktoraturë).

Gjithashtu kjo gjen mbështetje edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr.GJ.A-Su.A 214/2023 të dt.09.10.2023, respektivisht në pikën II të të këtij mendimi juridik.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata e datës 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të. Për gjykatën, edhe pretendimi se paditësja nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative është i pabazuar, pasi e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare e me ligj, dhe në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/7-212) sipas të cilit nen parashihet se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Kamata ligjore prej 8% në vite është përcaktuar në mbështetje të nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën” kurse lartësia e kamatës vonesë është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore në mbështetje në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00€ dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 40.00€, për dy seanca të mbajtura shumën prej nga 135 Euro, shumen prej 270, per dy seanca të shtyera shumen prej nga 67.50€, shumen prej 135€, për ekspertizën shumën prej 150 Euro, e në shumën e përgjithshme prej 699.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë,  
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil  
C.nr.216/2024, më datë 06.03.2024**

**Gjyqtari,  
Gazmend Ajvazi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.